



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT KULTURËS DHE SPORTIT**  
**TEATRI KOMBËTAR EKSPERIMENTAL “KUJTIM SPAHIVOGLI”**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026

**Njoftim për vend të lirë pune**

Në zbatim të “Urdhëri i Kryeministrit Nr. 201, datë.25.08.2014 për “*Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”*”, Kodit të Punës, të ligjit nr. 90 datë. 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administrates shtetërore, të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, të nenit 20, ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Drejtoria e Zhvillimit Artistik pranë Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, shpall konkurrimin për 3 (tre) vende të lira në pozicionin:

**Aktor i dytë**

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme, si njohës të mirë të administratës dhe menaxhimit të produksioneve artistike, si dhe kërkesat e veçanta në vijim:

**Kërkesa të veçanta për kandidatin:**

- Të jetë i pajisur me diplomë Bachelor ose Master në Arte Skenike, në degën e aktrimit, regjisë ose koreografisë.
- Të ketë eksperiencë pune si aktor, regjisor, koreograf ose performues (kërcimtar/balerin) në shfaqje teatrore, kinematografi dhe projekte artistike.
- Të ketë aftësi organizative dhe bashkëpunuese me stafin, si edhe aftësi ndërveprimi në realizimin e shfaqjeve artistike.
- Grupmosha 25–35 vjeç përbën avantazh.
- Të zbatojë rregullat e etikës në administratën publike.
- Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe të punës në grup.
- Si pjesë e dokumentacionit të aplikimit, kandidati duhet të paraqesë edhe dosjen artistike të punës së tij/saj (portfolë artistike), e cila do të merret në konsideratë dhe do të ketë prioritet në procesin e përzgjedhjes.

**Paga e pozicionit:** është në kategorinë e dytë me pagën bazë 91 000 lekë , si dhe shtesat sipas VKM nr.325 datë 31.05.2023.

## **Paraqitja e dokumentave:**

Aplikimi fillon në datë 16.06.2026 dhe përfundon më datë 29.06.2026 ora 14:00. Tre ditë pas mbarimit të aplikimit do të bëhet shpallja e fituesit. Aplikanti do të dorëzojë dokumentat e kërkuara, në Sekretarinë e Teatrit Kombëtarë Eksperimental “Kujtim Spahivogli” adresën; Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, Rr.”Sami Frashëri” (ArTurbina) Tiranë”, (në sekretarinë e T.K.E.K.S.) këto dokumenta:

- Kërkesë me shkrim për pozicionin e punës së shpallur
- Curriculum vitae
- Fotokopje e një dokumenti identifikimi
- Fotokopje e diplomës të arsimit përkatës
- Dosjen artistike të punës së tij/saj (portfolë artistike),
- Dokument për kualifikime, dëshmi trajnimesh të ndryshme, etj (nëse ka)
- Fotokopje të librezës së punës.
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore.
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit
- Dokumentet duhen të paraqiten vetëm në gjuhën shqipe.

*Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit.*

**KONKURIMI:** Është i hapur